



ATLET

UDHËZUES REFERIMI PËR ATLETËT
NË KODIN BOTËROR ANTI-DOPING 2015



WORLD
ANTI-DOPING
AGENCY

play true



TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA 1	Gjërat e duhura.....	P.2
PJESA 2	Kodi.....	P.3
PJESA 3	Aplikimi i kodit.....	P.3
PJESA 4	Roli dhe përgjegjësitë.....	P.5
PJESA 5	Çfarë është dopingu?.....	P.6
PJESA 6	Lista e ndaluar.....	P.10
PJESA 7	Përjashtimet e përdorimit terapeutik (TUE).....	P.12
PJESA 8	Testimi, mbledhja e ekzemplarëve dhe analiza e ekzemplarëve.....	P.13
PJESA 9	Pasojat e shkeljes së rregullave anti-doping.....	P.16
PJESA 10	Kthim në të ardhmen.....	P.20
SHTOJCA 1	Procesi i mbledhjes së ekzemplarëve.....	P.22
SHTOJCA 2	Procesi i ekzemplarit B.....	P.27

Qëllimi i Kodit Botëror Anti-Doping është të mbrojë të drejtat e atletit të pastër.

PJESA

1

GJËRAT E DUHURA

Kodi Botëror Anti-Doping përcakton rregullat që ju, si atlet, duhet ti ndiqni. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që t'ju ndihmojë të kuptoni rregullat.

**Ky dokument është
thjesht një udhëzues.
Ky nuk është një
zëvendësues për
kuptimin e Kodit.**

Ky dokument është thjesht një udhëzues. Ky nuk është zëvendësim për gjuhën e Kodit. Për ta theksuar: gjuha e Kodit është gjithmonë burimi kryesor. Ky udhëzues jepet në këtë mënyrë thjesht për qëllim të kuptuarit dhe në asnjë mënyrë nuk është një dokument juridik detyrues.

Kodi, në faqet e tij të para, flet për vlerën e perceptuar të "frymës së sportit". Kjo frymë është ajo që drejton përpara qëllimin parësor të çdo programi anti-doping: Parandalimin.

Kjo është për të parandaluar përdorimin me ose pa dashje të substancave apo metodave të ndaluara, ose kryerja e çfarëdo shkelje të rregullave anti-doping.

Çfarë, ekzaktësisht, është

Kodi Botëror Anti-Doping?

Kodi është korniza e sistemit anti-doping. Ai është pranuar nga e gjithë lëvizja olimpike, si dhe nga organet e ndryshme sportive dhe organizatat kombëtare Anti-Doping në gjithë botën. Kodi gjithashtu është njohur nga më shumë se 170 qeveri, përmes Konventës së UNESCO-s kundër dopingut në sport.

Kodi për herë të parë hyri në fuqi në Korrik të vitit 2004. Një grup i parë i amendamenteve hyri në fuqi më 1 Janar 2009. Një set i dytë do të hyjë në fuqi më 1 Janar 2015.

Teksti i plotë i Kodit mund të gjendet në faqen e internetit të Agjencisë Botërore Anti-Doping.

Në mbështetje të Kodit, WADA ka zhvilluar gjithashtu "standardet ndërkombëtare" për fusha të ndryshme teknike dhe operacionale, duke përfshirë listën e substancave dhe metodave të ndaluara, testimin dhe hetimet, Përgjashtimet e Përdorimit Terapeutik, laboratorët dhe Mbrojtjen e Privatësisë dhe të Dhënave Personale.

Referencat në këtë udhëzues për "Nenet" janë kryesisht nene të Kodit; referenca për dokumentet e tjera, të tilla si Standardet Ndërkombëtare do të jenë më specifike.

Kush është subjekt i Kodit?

1. Nëse ju jeni një atlet i nivelit kombëtar- apo ndërkombëtar- atëherë Kodi aplikohet ndaj jush. Atletët e "nivelit ndërkombëtar" përcaktohen nga Federata Ndërkombëtare e atletëve. Atletët e "nivelit kombëtar" përcaktohen nga Organizata Anti-Doping Kombëtare e atletëve.
2. Çdo Organizatë Kombëtare Anti-Doping mund të vendosë nëse dhe si do të zbatohet Kodi në qoftë se ju jeni një atlet që konkurren brenda vendit në një nivel që nuk ju identifikon si "nivel kombëtar". Nëse ju konkurren në këtë nivel, Organizata Kombëtare Anti-Doping ju teston, dhe nëse rezultoni pozitiv apo manipuloni procesin e kontrollit ose kryeni një tjetër shkelje të rregullit anti-doping, atëherë Kodi imponon sanksione.
3. Nëse ju nuk jeni duke marrë pjesë në garim, por angazhoheni vetëm në aktivitete rekreative apo në palestër, Organizata Kombëtare Anti-Doping, ka diskrecion të vendosë nëse dhe si do të zbatohet Kodi.



RREGULLAT DHE PËRGJEGJËSITË

Si një atlet, ju keni disa role dhe përgjegjësi. Këto përfshijnë:

- > Ju duhet të dini dhe të pajtoheni me të gjitha "rregullat dhe politikat e aplikueshme anti-doping".
- > Ju duhet të merrni përgjegjësi për çfarë "gëlltisi", që do të thotë çfarë pini dhe hani dhe çdo gjë tjetër që hyn në trupin tuaj. Rregulli esencial është ky: nëse është në trupin tuaj, ju jeni përgjegjës për të. Në terma ligjor, kjo quhet " përgjegjësi e rreptë".
- > Ju duhet të jeni të disponueshëm për mbledhje të ekzemplarëve.
- > Ju duhet të informoni personelin mjekësor se ata janë të detyruar të mos ju japin substanca apo metoda të ndaluara. Gjithashtu, ju jeni përgjegjës që çdo trajtim mjekësor që merrni të mos shkel Kodin.
- > Ju duhet të bashkëpunoni me organizatat anti doping që hetojnë shkeljet e rregullave anti doping.
- > Për më shumë detaje, shikoni Nenin 21.1.

Trajnerët, manaxherët, agjentët dhe personeli mbështetës janë shpesh modele për atletët. Ata, gjithashtu, kanë disa të drejta dhe përgjegjësi. Këto përfshijnë:

- > Ata duhet të njohin dhe pajtohen me politikat dhe rregullat që aplikohen ndaj tyre dhe ndaj atletëve që ata mbështesin.
- > Ata duhet të bashkëpunojnë me programin e testimit të atletit.
- > Ata duhet të përdorin influencën e tyre të konsiderueshme për të promovuar një filozofi të sportit të pastër.
- > Ata duhet të bashkëpunojnë me Organizatat Anti Doping që hetojnë shkeljet e rregullave anti doping.
- > Ata nuk duhet të posedojnë apo përdorin substanca apo metoda pa një justifikim të vlefshëm.
- > Për më shumë detaje shikoni Nenin 21.2.

ÇFARË ËSHTË DOPINGU?

Si një atlet, Kodi specifikisht thotë se ju jeni përgjegjës për të ditur se çfarë përbën një shkelje të rregullit anti-doping.

Shkeljet mund të përfshijnë më shumë se vetëm një test pozitiv.

Shkelje të tilla mund të përfshijnë më shumë se vetëm një test pozitiv – i cili, në gjuhën e Kodit, quhet "Konstatim Anormal i Analizave".

Për shembull, është gjithashtu një shkelje e rregullit anti doping përdorimi dhe posedimi i substancave dhe metodave të ndaluara.

Ka gjithashtu lloje të tjera të shkeljeve të rregullave anti doping. Kodi parashikon:

- > Manipulimi ose tentativa për manipulim gjatë një pjesë të kontrollit për doping. Për shembull, ndërhyrjen e qëllimshme ose tentativën për ndërhyrje tek një zyrtar i kontrollit doping ose presioni tek një dëshmitar i mundshëm ose ndryshimin e ekzemplarit duke shtuar një substancë të huaj. Shiko Neni 2.5.
- > Zotërimi i një substance ose metode të ndaluar. Nuk është e rregullt të bleni ose të mbani një substancë të ndaluar me qëllim dhënien e tij një miku apo familjari, përveç disa rrethanave mjeksore shumë të kufizuara të justifikuara – për shembull, blerja e insulinës për një fëmijë diabetic. Shiko Nenin 2.6.
- > Trafikimi ose tentativa e trafikimit të një substance ose metode të ndaluar. Shiko Nenin 2.7.
- > Administrimi ose tentativa e administrimit të një substance ose metode të ndaluar për një atlet. Shiko Nenin 2.8.
- > Bashkëpunimi. Kjo përfshin një diapason të gjerë veprimesh: ndihma, inkurajimi, mbështetja, lehtësimi, fshehja, mbulimi ose “një lloj tjetër bashkëpunimi” që përfshin shkeljen e rregullit anti doping apo tentativa e shkeljes së një rregulli anti doping nga një person tjetër. Shiko Nenin 2.9.
- > Marrëdhëniet e ndaluara Shiko Nenin 2.10.
- > Dështimet në lidhje me Vendodhjen Shiko Nenin 2.4.
- > Shmangia, refuzimi ose mosdhënia e ekzemplarit. Shiko Nenin 2.3.

Ju duhet të jeni të ndërgjegjshëm se një shkelje e rregullit anti doping mund të provohet me çdo mjet të besueshëm. Kjo përfshin rezultatet laboratorike dhe të dhëna të tjera – termi i përdorur është, provë “jo-analitike”. Kjo provë mund të përfshijë por nuk është e kufizuar tek “Pasaporta Biologjike e Atletit” (një studim në kohë të një numri të parametrave tuaj biologjikë), pranimet, dëshmia e dëshmitarëve dhe lloje të ndryshme të provave të dokumentuara.

A merret parasysh qëllimi kur bëhet fjalë për një shkelje të rregullit anti doping?

Siç u tha më përpara, ju jeni përgjegjës – “përgjegjësi e rreptë” – për çdo gjë dhe gjithçka në sistemin tuaj. Për të vendosur një shkelje të rregullit anti doping për përdorimin apo prezencën e një substance të ndaluar, nuk është e nevojshme të demonstrohet qëllimi, fajti, neglizhenca apo njohja e përdorimit nga ana juaj.

Nuk është mbrojtje ndaj një shkelje të rregullit anti doping se, për shembull, dikush në shoqërinë apo kapmin tuaj ju dha një substancë; apo se një substancë e ndaluar nuk ishte listuar në përshkrimin e produktit; apo se një substancë apo metodë e ndaluar nuk do të kishte përmirësuar performancën tuaj.

Nëse ju përdorni apo provoni një substancë apo metodë të ndaluar, që është doping. “Suksesi” apo “Dështimi” e përdorimit apo tentativës së përdorimit nuk ka rëndësi. Konsiderohet doping. Për më shumë detaje, shiko Nenin 2.1 dhe 2.2.

Nëse nuk jeni të sigurt çfarë ka në një produkt, mos e merrni atë. Injoranca nuk është asnjëherë justifikim.

Po përsa i përket shtojcave dietike?

Në shumë vende, regullorja e shtojcave dietike mund të jetë shumë e shkujdesur. Nuk është e pazakontë që shtojcat e tregtuara në dyqanet e ushqimeve shëndetësore apo në Internet të përmbajnë substanca të ndaluara që nuk janë listuar në etiketën e produktit. Në vitet e fundit, një numër i analizave pozitive i është atribuar shtojcave të përshkruara gabim apo të kontaminuara.

Për të përdorur vetëm një shembull, ka patur një numër të lartë çështjesh në vitet e fundit, përfshirë në Lojrat Olimpike, atletë në sporte të ndryshme rezultojnë pozitivë në teste për stimulantin metileksaneaminë (MHA). Ky stimulant mund të njihet gjithashtu si, midis të tjerave, 1,3 – dimetilaminë ose DMAA; mund të quhet gjithashtu ekstrakt i rënjës geranium ose vaj geranium (edhe nëse nuk vjen nga vaji apo bima geranium). Këto emra mund të jenë – ose mos të jenë – në etiketën e një produkti. Por “metileksaneamina” rallë është, megjithëse është në listën e ndaluar.

Ju duhet të jeni ekstremalisht të kujdesshëm për produktet, që midis të tjerave, pretendojnë të risin muskujt, ndihmojnë në rigjenerim, japin energji apo ndihmojnë në humbjen e peshës. Ju do të mbaheni përgjegjës në mënyrë rigorozë për pasojat e një testi pozitiv nga shtojca të përshkruara gabim, këshilla më e mirë është: ju nuk duhet të merrni shtojca nëse keni dyshime mbi çfarë ajo mund të përmbajë.

Ju nuk duhet të merrni shtojca nëse keni dyshime mbi çfarë ajo mund të përmbajë.

Rregulli i “Vendodhjes”

Qëllimi kryesor i kërkesave të Vendodhjes është të lehtësoj testimet jashtë garave.

Dhënia e informacionit të Vendodhjes i jep Organizatës Anti-Doping aftësinë për t’ju gjetur, si dhe, të mbështetet në kontrollë të pa lajmëruara për të maksimizuar potencialin për të kapur atletë që dopohen. Testimi pa lajmërim është gur themeli i një programi efektiv anti-doping.

Testimi pa lajmërim është gurë themeli i një programi efektiv anti-doping.

Relativisht pak atletë janë në “Listën e Regjistrimit të Analizave” dhe duhet të japin informacion të saktë dhe aktual mbi Vendodhjen.

Nëse ju jeni njoftuar se jeni në një “listë regjistrimi analizash”, kjo do të thotë se keni dhënë informacion tremujor mbi Vendodhjen. Plotësimi përfshin aktivitete

të planifikuara dhe një hapësirë kohore një orë çdo ditë ku ju mund të jeni të disponueshëm për testim. Aktivitetet dhe hapësira e testimit duhet të përditesohen.

- **Nëse ju dështoni të plotësoni në kohë formularin tremujor, ju keni kryer një dështim plotësimi.**
- **Nëse ju nuk jeni në vendin që deklaroni që do të jeni gjatë hapësirës kohore prej një ore, ju keni kryer një test të humbur.**

Ju keni të drejtën të kundërshtoni çdo dështim plotësimi apo test të humbur pranë Organizatës Anti-Doping përkatëse. Çdo kombinim i tre dështim plotësimi apo test të humbur brenda një periudhe kohore prej 12 muaj – nëse nuk kundërshtohet me sukses nga ju – rezulton në një shkelje të rregullave anti-doping.

Nëse merrni pjesë në një sport ekipor, dhe jeni regjistruar në **Listën e Regjistrimit të Analizave**, ju jeni subjekt për të njëjtat rregulla të Vendodhjes si atletët që konkurojnë në një sport individual.

Atleti i sportit ekipor apo individual **mund të delegojë** disa ose të gjitha plotësimet e vendodhjes tek një trajner, manaxher apo palë të tretë; megjithatë, **çdo atlet në fund të fundit mbetet përgjegjës për dorëzimin e saktë dhe të plotë të informacioneve të vendodhjes.**

Vendodhjet e skuadrës gjithashtu mund të plotësohen në Organizatën Anti-Doping për aktivitete që përfshijnë një Skuadër. Shiko Standartin Ndërkombëtar për Testim dhe Hetim (ISTI) Neni 4.8.2.

Organizatata Anti-Doping mund ti kërkojë ateltëve të caktuar të cilët nuk janë të regjistruar në një listë regjistrimit të analizave të japin informacione më pak të detajuara për vendodhjen. Nesë ju jeni një nga këta atletë; dështimi për të përmbushur kërkesat e vendodhjes nuk konsiderohet një shkelje e rregullave anti-doping por mund të sjellë pasojë të vendosura nga Organizata juaj Anti-Doping.

Çfarë është “marrëdhënia e ndaluar”?

Ka disa shembuj të nivelit të lartë të atletëve që kanë vazhduar të punojnë me trajnerë të cilët janë ndëshkuar apo me individë të cilët janë dënuar penalisht për dhënien e drogave që rrisin performancën.

Një veçori e re e Kodit e cila merr efekt me filimin e vitit 2015 konsideron shkelje të rregullave anti-doping marrëdhënia me këtë lloj "personi që mbështet atletin" në një kohë që jeni paralajmëruar specifikisht të mos angazhoheni në atë marrëdhënie.

DETAJE

Ju nuk duhet të punoni me trajnerë, doktorë apo të tjerë të cilët janë të papërshtatshëm për shkak të shkeljes të një rreguli anti-doping apo që janë ndëshkuar penalisht apo me sanksione disiplinore, në lidhje me dopingun.

Disa shembuj të kësaj marrëdhënie të ndaluar përfshin marrja e trajnimit, strategjisë, ushqimit apo këshillimit mjekësor, terapisë, trajtimit apo recetës. Për më tepër, “personi që mbështet atletin” nuk mund të shërbejë si një agjent apo përfaqësues. Marrëdhënia e ndaluar kërkon mos përfshirjen në çdo formë shpërblym.

Kjo dispozitë nuk aplikohet në rrethana ku marrëdhënia nuk është e lidhur me anën profesionale apo me fushën sportive. Shembull: një marrëdhënie prind-fëmijë apo burrë-grua.

Për më shumë detaje, shiko Neni 2.10.

Cilat substanca dhe metoda

janë të ndaluara ?

WADA mban një listë substancash dhe metodash që janë të ndaluara. Ajo përditëson periodikisht këtë Listë të Substancave dhe Metodave të Ndaluar, më e pakta çdo vit. Lista e përditësuar normalisht aplikohet nga 1 Janari çdo vit dhe është e disponueshme disa muaj përpara në websitin e WADA-s.

Ju jeni përgjegjës për tu njohur me substancat dhe metodat në Listën e Ndaluar.

Ju jeni përgjegjës për tu njohur me substancat dhe metodat në Listën e Ndaluar.

Lista është e ndarë në substanca që janë :

1. të ndaluara përgjithmonë dhe
2. të ndaluara brenda garës (siç përcakton çdo sport por më së shumti brenda 24 orëve të garës). Ato substanca që janë të ndaluara përgjithmonë përfshijnë (por nuk janë të kufizuara për) : hormone, anabolik, EPO, agonist beta-2, agjentë maskues dhe diuretik.

Ato substanca që janë të ndaluara vetëm brenda garës, do të përfshinin, por nuk do të kufizoheshin nga: stimulantë, marihuanë, narkotikë dhe glukokortikosteridë.

Gjithashtu të ndaluara përgjithmonë : metoda si tranfuzioni apo manipulimi i gjakut, apo në disa raste injeksione intravenoze.

Kush është ndryshimi midis substancave

të ndaluara përgjithmonë dhe ato të

ndaluara brenda garës ?

E ndaluar përgjithmonë do të thotë e ndaluar përgjatë gjithë vitit, përfshirë stërvitjen dhe brenda garës gjithashtu. Për shembull: steroidë anabolik, që kur përdoren gjatë stërvitjes mund të kenë efekte të rritjes së performancës në terma afatgjatë, apo agjentë maskues, që përdoren për të fshehur shenjat e dopimit.

Në kontrast, përdorimi i substancave jashtë garës që janë të ndaluara vetëm brenda garës nuk konsiderohet një shkelje e rregullave anti-doping përveçse shenja të asaj substance gjenden akoma në sistemin tuaj gjatë testimit brenda një gare. Që të jemi të qartë, shumë substanca mund të mbeten në sistemin tuaj për një kohë të gjatë. Nëse ju ktheni një rezultat pozitiv për një substancë që e keni marrë jashtë garës (e cila nuk ishte e ndaluar gjatë kohës që e keni marrë) dhe testoheni pozitiv për atë gjatë kontrollit doping gjatë garës (ku është e ndaluar), ju do të akuzoheni për një shkelje të rregullave anti-doping.



Mund të gjenden substanca të ndaluara në mjekime të zakonshme?

Po. Çfarëdo numri mjekimesh të zakonshme, përfshirë ilaçet kundër dhimbjes dhe trajtimet e të ftohtit dhe gripit, mund të përmbajnë substanca të ndaluara.

Për më shumë informacion, shikoni burimet e dhëna nga Federata Ndërkombëtare ose Organizata Kombëtare Anti-Doping.

PËRJASHTIMET E PËRDORIMIT TERAPEUTIK (TUE)

Një nga principet kryesore e përpjekjes anti-doping është të mbrojë shëndetin tuaj. Mund të ndodhë që, për arsye shëndetësore, ju keni nevojë të merrni një substancë apo metodë të ndaluar. Ju mund ta bëni këtë sipas Kodit. Çelësi është se ju duhet ta merrni atë që quhet një “Përrjashtim Përdorimi Terapeutik”, apo TUE.

Disa kritere duhet të plotësohen për të siguruar një TUE, siç janë: përdorimi i substancës (apo metodës) së ndaluar është e nevojshme për shëndetin tuaj; përdorimi i saj nuk duhet të rrisi performancën tuaj përtej kthimit në shëndetin normal; dhe nuk ka alternativë terapeutike të arsyeshme tjetër për përdorimin e substancës apo metodës së ndaluar.

Një nga principet kryesore e përpjekjes anti-doping është të mbrojë shëndetin tuaj.

Atletët e nivelit ndërkombëtar dhe kombëtar duhet të kuptojnë një aspekt tjetër të rëndësishëm të rregullave: përveç emergjencave ose rrethanave të jashtëzakonshme, një TUE duhet të sigurohet paraprakisht, jo në mënyrë retroaktive. Shiko Nenin 4.3 të Standardeve Ndërkombëtare të

Përrjashtimit të Përdorimit Terapeutik (ISTUE).

TUE-s për atletët kombëtar mbikëqyren nga Organizata juaj Kombëtare Anti Doping. TUE-s për atletët ndërkombëtar administrohen nga Federata juaj Ndërkombëtare. Lojrat Olimpikë dhe garat e mëdha multi-sportive mund të japin vetë TUE-t e tyre. Shiko Nenin 4.4.

Ju duhet të verifikoni me Federatën tuaj Ndërkombëtare apo Organizatën Kombëtare Anti-Doping kur një aplikim i ri duhet të dorëzohet apo kur një TUE e dhënë më përpara

Një TUE duhet marrë paraprakisht, jo në mënyrë retroaktive.

mund të përcillet për miratim. Organizata juaj Anti-Doping duhet t'ju drejtojë përgjatë këtij procesi.

Asnjëherë mos e gjykoni të mirëqenë se TUE-ja juaj kombëtare do të miratohet automatikisht në nivelin ndërkombëtar. Nëse keni ndonjë dyshim, kontrolloni me Federatën tuaj Ndërkombëtare apo organizuesin e lojrave

multi-sportive.

Një tabelë që qartëson këtë process mund të gjendet në Aneksin 1 të **ISTUE**

TESTIMI, MBLEDHJA E EKZEMPLARËVE DHE ANALIZA E EKZEMPLARËVE

Kur një officer i autorizuar i kontrollit doping ju kërkon të jepni një ekzemplar, ju duhet ta bëni atë.

Çdo Organizatë Anti-Doping me autoritet mbi një atlet ka të drejtë të mblëdhë ekzemplarë urine dhe/ose gjaku nga një atlet në çdo kohë dhe vend dhe ti analizojë ato ekzemplarë për qëllime anti-doping.

Kush ka autoritet testimi?

Kush ka autoritet testimi?

Organizatat Kombëtare Anti-Doping kanë autoritet mbi atletët

1. të cilët janë kombëtar, banues, mbajtës license apo anëtar të organizatave sportive të atij vendi, ose
2. të cilët janë prezent në vendin e asaj Organizate Kombëtare Anti-Doping, ose
3. ku rregullat e një Federate Ndërkombëtare në rastin e kundërt u japin atyre autoritet më të gjerë.

Federatat Ndërkombëtare kanë autoritet mbi atletët të cilët janë subjekt ndaj rregullave të tyre,

1. përfshirë atletët që garojnë në evente të caktuara ndërkombëtare, dhe
2. atletët të cilët janë anëtarë apo mbajtës license të asaj Federate Ndërkombëtare (apo anëtarët e saj direkt apo indirect).

Organizuesit e aktiviteteve madhore, në përgjithësi kanë autoritet mbi atletët që marrin pjesë në aktivitetin e tyre.

WADA normalisht nuk inicion testime por ka autoritetin për të testuar. Në rastin kur WADA inicion testime, kontraktin kryerjen aktuale të testimit tek Organizatat e tjera Anti-Doping.

Mbledhja e ekzemplarëve është e standardizuar. Për më shumë rreth procesit dhe të drejtave tuaja gjatë procesit, shikoni Aneksin 1.

Në mënyrë për të vendosur një shkelje të bazuar në prezencën e një substance të ndaluar në ekzemplarin e një atleti, vetëm ato laboratore që janë akredituar apo specifikisht miratuar nga WADA mund të analizojnë ekzemplarët. Shiko Aneksin 2 për më shumë rreth të drejtave tuaja në lidhje me analizën e ekzemplarit B nëse ekzemplari A është raportuar si një Konstatim Anormal Analitik.

Për sa kohë mbahen ekzemplarët?

Ekzemplarët mund të ngrihen, ruhen dhe ri-analizohen për 10 vjet.

Ekzemplarët mund të ngrihen, ruhen dhe ri-analizohen për 10 vjet. Teknologjia po avancohet me shpejtësi. Disa substanca dhe metoda të ndaluara, të cilat nuk janë të detektueshme sot, mund të jenë në të ardhmen. Potenciali i ekzemplarëve të ruajtur mund të analizohen në të ardhmen dhe shërbejnë si një dekurajim i fortë nëse ju, apo kushdo që njihni, për ndonjë arësye, do të konsideronit të merrni doping.

Kur ekzemplarët nuk përdoren më për qëllime anti-doping, ato do të bëhen anonime dhe do të përdoren për qëllime të sigurimit të cilësisë, do të hidhen poshtë ose, me miratimin tuaj paraprak me shkrim në formularin e kontrollit të dopingut, do të përdoren për qëllime kërkimore.

Kthimi në garë pas tërheqjes

Nëse ju tërhiqeni gjatë kohës që jeni të regjistruar në listën e regjistrimit të analizave të një Federate Ndërkombëtare ose Organizate Kombëtare Anti-Doping, ju duhet të jepni një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara me dëshirën tuaj për tu kthyer në gara. Gjatë këtyre **gjashtë muajve**, ju duhet të pranoni të jeni subjekt i rregullave anti-doping dhe të jenë të disponueshëm për teste përpara se të lejoheni të garoni përsëri.

Nëse aplikimi i rreptë i këtij rregulli do të ishte “qartësisht i padrejtë”, WADA mund të japë një përjashtim. Shiko Nenin 5.7.

Nëse ju tërhiqeni gjatë kohës që jeni të regjistruar në listën e regjistrimit të analizave, ju duhet të njoftoni me shkrim gjashtë muaj përpara me dëshirën tuaj për tu kthyer në gara.



Çfarë është ADAMS?

ADAMS (Sistemi i Menaxhimit dhe Administrimit Anti-Doping) është sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave anti-doping të bazuar në web-in e WADA-s. ADAMS ruan, në rezultate të veçanta laboratorike, Përrjashtime të Përdorimit Terapeutik dhe informacione mbi Shkeljet e Rregullave Anti-Doping. Kjo bazë të dhënash lehtëson ndarjen e informacioneve midis organizatave respektive dhe ka për qëllim të promovojë efikasitetin, efektivitetin edhe transparent.

Shumica e Federatave Ndërkombëtare dhe Organizatat Kombëtare Anti-Doping përdorin ADAMS si qendër bazë informacioni për të dhënat e Vendodhjes së atletëve, TUE-t dhe rezultatet e testeve. ADAMS është zhvilluar që ta bëjë jetën tuaj të lehtë.

Ju keni akses tek informacioni juaj në ADAMS. Federatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Kombëtare Anti-Doping janë përgjegjëse për dhënien e aksesit tuaj tek ADAMS. Vetëm nje personel i kufizuar brenda Organizatave Anti-Doping kanë akses tek të dhënat tuaja. Sistemi multi-nivel i sigurisë së ADAMS mbron sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave tuaja.

PASOJAT E SHKELJES SË RREGULLAVE ANTI-DOPING

Pasojat e shkeljes së rregullave anti-doping mund të përfshijnë skualifikimin e rezultateve, imponim i një periudhe të papranueshmërisë, publikim i detyruar i shkeljes tuaj dhe, mbase, sanksione financiare.

SKUALIFIKIMI I REZULTATEVE

Një shkelje e rregullit anti-doping në sport individual në lidhje me një garë (për shembull, një garë apo lojë individuale) automatikisht rezulton në skualifikimin e rezultateve të përfutuara në atë garë. Shiko Nenin 9.

Çfarë do të thotë skualifikim?

Do të thotë skualifikimin e të gjithë rezultateve, medalje, shpërblime në para dhe çmime. Rezultatet tuaja në garat e të njëjtit event – për shembull, Lojrat Olimpikë – mund të skualifikohen gjithashtu. Nenin 10.1.

Ne përgjithësi, rezultatet skualifikohen në mënyrë retroaktive – përveç “kur drejtësia e kërkon ndryshe” – nga data e shkeljes së rregullit anti-doping (për shembull, data e mbledhjes së ekzemplarit pozitiv) deri në fillimin e pezullimit provizor ose të periudhës së papërshtatshmërisë. Shiko Nenin 10.8.

PAPËRSHTATSHMËRI (MOS PASJA E TË DREJTËS)

Papërshtatshmëri do të thotë ekzaktësisht atë që shpreh – ju nuk mund të merrni pjesë në asnjë garë apo aktivitet të Federatës Ndërkombëtare, të federative kombëtare anëtare dhe klubet e tyre anëtare. Kjo përfshin trajnimin me klubin apo skuadrën tuaj apo përdorimin e ambienteve që janë në lidhje me klubin apo skuadrën tuaj.

Në mënyrë të ngjashme, ju nuk mund të merrni pjesë në asnjë garë të autorizuar apo organizuar nga nënshkruesit e Kodit (siç janë Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar, Komiteti Olimpik Kombëtar) apo me entet e tyre të lidhur.

Gjithashtu, ju nuk mund të merrni pjesë në asnjë kampionat profesional apo event të nivelin ndërkombëtar apo kombëtar apo aktivitete sportive elitare apo të nivelit kombëtar të financuara nga një organizatë qeveritare. Shiko Nenin 10.12.1.

Sa zgjat periudha e papërshtatshmërisë?

Një konsensus i fortë ka dalë në mbarë botën dhe në veçanti midis atletëve, që mashtruesit e qëllimshëm të mos jenë të përshtatshëm për pjesmarje për katër vjet.

A është gjithmonë katër vjet?

Jo.

A mundet që një shkelje e rregullit anti-doping në të vërtetë të çojë në asnjë periudhë të papërshtatshmërisë?

Po – vetëm nëse atleti arrin të vërtetojë asnjë faj apo neglizhencë.

Gjithashtu, në disa raste të veçanta, në lidhje me substancat e ndaluara, një paralajmërim mund të lëshohet nëse niveli i fajit të atletit është shumë i vogël – jo irëndësishëm. I njëjti rregull aplikohet për produktet e kontaminuara – në mënyrë tipike shtojcat dietike – të përcaktuara si ato produkte që përmbajnë substanca të ndaluara që nuk janë të përshkruara në etiketën e produktit apo në informacionin e dhënë për kërkimin në internet.

Në çfarë game faktorësh bazohet periudha e papërshtatshmërisë?

Lloji i shkeljes, substanca apo metoda e ndaluar, natyra e sjelljes së atletit dhe niveli i fajit të atletit.

SI BASHKOHEN TË GJITHË KËTO RREGULLA?

Për shkeljen e prezencës apo përdorimit të substancave të ndaluara, rregullat bazë janë si vijojnë:

Nëse ju keni për qëllim të mashtroni, çfarëdo substance, periudha e mospasjes së drejtë është katër vjet.

Në të kundërt, është dy vjet – vetëm nëse ju mund të tregoni se ju nuk keni patur faj apo neglizhencë të dukshme, në të cilin rast mospasja e të drejtës mund të ulet maksimalisht në një vit (që është minimalisht në një vit papërshtatshmëri për pjesmarje).

Nëqoftëse shkelja përfshin një substancë specifike ose një product të ndotur dhe ju mund të tregoni se ju nuk kishit faj të dukshëm, papërshtatshmëria për pjesmarje mund të variojë nga dy vjet deri në qortim. (në varësi të nivelit të fajit).

Për periudhën e papërshtatshmërisë për pjesmarje dhe shkelje të tjera të rregullave anti-doping shiko Nenin 10.3.

Bashkëpunimi dhe “ndihmën thelbësore”

Bashkëpunimi i ateltëve dhe atyre që njohin gabimet e tyre dhe që janë të gatshëm të bëjnë një hap përpara për të vënë shkeljet anti-doping përpara drejtësisë janë esenciale për një sport të pastër.

Kodi e njeh këtë rrethanë të veçantë.

Një periudhë papërshtatshmërie mund të ulet (me rreth gjysmën e periudhës ndryshe të zbatueshme) nëse atleti me vullnetin e tij pranon dopimin para marrjes së njoftimit nga Organizata Anti-Doping që konstaton një shkelje të rregullores dhe në momentin që pranimi është e vetmja provë e besueshme për shkeljen – kjo gjithmonë nëse ai apo ajo del përpara me vullnetin e tij apo të saj.

Periudha e papërshtatshmërisë e një atleti mund të ulet dukshëm nëse ai apo ajo i jep “ndihmë thelbësore” një Organizate Anti-Doping, policisë apo autoritetit të ndjekjes penale apo trupit disiplinor profesional, e cila rezulton në hapjen e një çështje të re (apo gjetjen e mundësisë për këtë) kundër dikujt tjetër nga ana e Organizatës Anti-Doping.

Çfarë është “ndihma thelbësore”? Do të thotë zbulim i plotë, me shkrim, çdo gjë që dini në lidhje me dopimin e çdo personi, përfshirë dhe ju. Gjithashtu, do të thotë bashkëpunim i plotë me autoritetet, përfshirë dëshmi në një seancë dëgjimore që kërkohet.

Për më shumë shikoni Nenet 10.6.1 dhe 10.6.2

TË PËRMBLEDHIM DISA PIKA NË LIDHJE ME PAPËRSHTATSHMËRINË

- > Nëse akuzoheni për një shkelje të rregullave anti-doping, një pezullim i përkohshëm mund të vendoset ndaj jush ose ju mund të pranoni me vullnetin tuaj një pezullim të përkohshëm pa kundërshtuar – që do të thotë të hiqni dorë- nga e drejta juaj për të kundërshtuar akuzën kundër jush.
- > Çdo periudhë papërshtatshmërie fillon
 1. në datën kur ju pranoni pezullimin e përkohshëm apo pranoni sanksionet e vendosura.
 2. në rastet e kundërshtimit, në datën që është dhënë vendimi pas seancës dëgjimore.
- > Nëse jeni në një periudhë papërshtatshmërie, ju mund të merrni pjesë në programe edukative anti-doping të autorizuara.
- > Gjithashtu ju mund të stërviteni me një skuadër apo të përdorni ambientet e një klubi gjatë periudhës më të shkurtër të:
 1. dy muajve të fundit të periudhës së papërshtatshmërisë, ose
 2. një të katërtën të fundit të periudhës së papërshtatshmërisë. Shiko Nenin 10.12.2
- > Shënim: disa pezullime të përkohshme janë të detyrueshme. Shiko Nenin 7.9.1.

PASOJAT FINANCIARE

Kodi nuk vendos gjoba për dopingun. Thënë kjo, nuk i ndalon Organizatat Anti-Doping nga vendosja e gjobave në rregulloret e tyre.

Sanksionet financiare nuk mundën kurrë të ulin apo zëvendësojnë një periudhë papërshtatshmërie.

Atletët e pasur nuk mund të paguajnë për të dalë jashtë periudhës së papërshtatshmërisë.

Për më shumë shiko Nenin 10.10.

DEKLARIMI PUBLIK I DETYRUESHËM

Nesë zbulohet një shkelje e një rregulli anti-doping, fakti do të bëhet publik. Idea është se shërben si një dekurajues i rëndësishëm kundër dopingut.

Një Organizatë Anti-Doping duhet, përveç rastit të një të mituri, publikojë emrin e atletit, natyrën e shkeljes së rregullave dhe pasojat brenda 20 ditëve pas vendimit përfundimtar.

Nëse vendimi përfundimtar përcakton se nuk ka patur asnjë shkelje, vendimi mund të deklarohet publikisht vetëm me pëlqimin e atletit. Shiko Nenin 14.3.2.

SPORTET EKIPORE

Nëse luani në sporte ekipore dhe gjendeni me doping, ju jeni subjek i të gjitha rregullave të Kodit. Përveç kësaj, mund të ketë pasoja për skuadrën tuaj. Sanksionet që mund të vendosen ndaj skuadrës tuaj do të përcaktohen nga trupi drejtues i garave në të cilat skudra juaj konkuron. Shiko Nenin 11.

PARASHKRIMI

Çdo procedim për shkelje të rregullave anti-doping duhet të fillojë brenda 10 viteve nga data kur shkelja është dyshuar të ketë ndodhur.

APELIMET DHE ANKIMET

Të gjithë atletët kanë të drejtën e apelimit përpara panelve paanshme. Gjithashtu kanë të drejtë të ankimojnë çështjet e tyre në kohën e duhur.

Nëse çështja juaj buron nga pjesëmarrja në një event ndërkombëtar apo nëse ju jeni një atlet i nivelit ndërkombëtar, ju dhe Organizata Anti-Doping të tjera, mund të ankimoni vendimet, ekskluzivisht tek Gjykata e Arbitrazhit Sportiv. Në të kundërt, vendimet mund të ankimohen tek një trup i pavarur dhe një trup kombëtar shqyrtues i paanshëm. Shiko Nenin 13.



PJESA

10

KTHIM NË TË ARDHMEN

Versioni i Kodit të 2015 sjell ndryshime të reja.

Gjithashtu sjell mundësi të reja për atletët e botës – dhe për pjesën më të madhe të atletëve, në fakt, që zgjedhin që të garojnë pastër – për të marrë drejtimin e rrugës në promovimin e atletëve të pastër.

Kontaktoni federatën tuaj sportive apo organizatën kombëtare anti-doping për informacione shtesë që janë specifike për vendin dhe sportin tuaj.

Vizitoni faqen e internetit të WADA për më shumë në **Progamet e Edukimit dhe Ndërgjegjësimit**.



SHTOJCA

1 PROCESI I MBLEDHJES SË EKZEMPLARËVE

11 HAPAT E MBLEDHJES SË EKZEMPLARËVE

Kjo shtojcë ka qëllim të japë një pamje të përgjithshme të procesit të kontrollit doping. Ju lutemi vini re se disa janë të veçanta, ndryshime të vogla për minorenët dhe atletët me aftëzi të kufizuara. Këto mund të gjenden në fund të kësaj shtojce.

Më shumë informacion mund të gjendet në faqen e internetit të WADA, ose nga

Organizata Kombëtare Anti-Doping apo Federata Ndërkombëtare e juaj.

Si filim, duhet të theksohet kjo: integriteti i ekzemplarit është gjithmonë çelësi. Një shmangie nga këto procedura nuk do të zhvlerësonte domosdoshmërisht një rezultat testi veç nëse integriteti i një ekzemplari është prekur.

1 PËRZGJEDHJA E ATLETIT

Ju mund të përzgjidheni për kontroll doping në çdo kohë dhe në çdo vend.

2 NJOFTIMI

Një Oficer i Kontrollit Doping apo shoqërues do t'ju njoftojë se jeni përzgjedhur për kontroll doping. Oficeri i Kontrollit Doping apo shoqëruesi do t'ju informojë për të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja. Këto përfshijnë të drejtën për të patur një përfaqësues prezent përgjatë procesit.

Do t'ju kërkohet të firmosni një formular ku konfirmoni se jeni zgjedhur për kontrolle doping.

3 RAPORTIMI TEK STACIONI I KONTROLIT DOPING

Ju duhet të raportoni menjëherë tek stacioni i kontrollit të dopingut.

Oficeri i Kontrollit Doping apo shoqëruesi mund t'ju lejojë të shtyni një raportim tek stacioni për një aktivitet, si konferencë shtypi apo përfundimin e një seance trajnimit. Megjithatë, pasi jeni njoftuar se jeni përzgjedhur për kontroll doping, Oficeri i Kontrollit Doping apo shoqëruesi do t'ju shoqërojë deri në përfundimin e procesit të kontrollit të ekzemplarit.

4 ZEGJEDHJA E ENËS MBLEDHËSE

Ju do të keni mundësi të zgjidhni individualisht një enë mbledhëse të mbyllur. Ju mund të zgjidhni një. Ju duhet të kontrolloni se pajisja është e paprekur dhe nuk është ngatëruar. Ju duhet, në çdo kohë, të mbani në kontroll enën mbledhëse.

5 DHËNIA E EKZEMPLARIT

Gjatë përgatitjes së ekzemplarit, vetëm ju dhe Oficeri i Kontrollit Doping apo shoqëruesi i të njëjtës Gjini keni leje në tualete.

Juve do t'ju kërkohet të lani duart.

Juve do t'ju kërkohet më pas të ngrini ose ulni veshjen tuaj në mënyrë që Oficeri i Kontrollit Doping apo shoqëruesi të kenë një pamje të qartë gjatë kohës që ju jepni ekzemplar.

6 VOLUMI I URINËS

Oficeri i Kontrollit Doping do të sigurohet që ju keni dhënë minimumin e volumit të kërkuar: 90 mL. Nëse herën e parë nuk mund të jepni 90 mL, do t'ju kërkohet që të jepni akoma deri sa të arrihet niveli i kërkuar.

7 NDARJA E EKZEMPLARIT

Ju do të keni mundësi të zgjidhni individualisht një kit mbledhës të ekzemplarëve. Zgjidhni një. Ju duhet të kontrolloni që pajisja është e paprekur dhe nuk është ngatëruar. Hapni kitin. Konfirmoni se kodi i ekzemplarit është i njëjtë në shishe, në kakap dhe në enë.

Tani ju duhet të ndani ekzemplarët, duke derdhur të paktën 30 mL në shishen B dhe urinën e mbetur në shishen A.

Juve do t'ju kërkohet një sasi e vogël në enën mbledhëse. Arsye e kësaj është që Oficeri i Kontrollit Doping të masë gravitetin specifik.

Derdhni urinën vetë përveç nëse ju duhet ndihmë. Në këtë rast, ju duhet të jepni pëlqimin tuaj për përfaqësuesin tuaj apo Oficerin e Kontrollit Doping që ta bëjë në vendin tuaj.

8 MBYLLJA E EKZEMPLARËVE

Më pas, mbyllni të dy shishet A dhe B. Ju (apo përfaqësuesi juaj) dhe Oficeri i Kontrollit Doping duhet të kontrolloni që shishet janë të mbyllura siç duhet.

9 MATJA E GRAVITETIT SPECIFIK

Oficeri i Kontrollit Doping duhet të masë gravitetin specifik të ekzemplarit. Nëse nuk përmbush kërkesat e duhura, ju duhet të jenpi një ekzemplar tjetër.

10 MBUSHJA E FORMULARIT TË KONTROLLIT DOPING

Në këtë formular, ju duhet të jepni informacion për çfarëdo ilaçi – me apo pa recetë – shtojca dietike që keni marrë kohët e fundit.

Ky formular është gjithashtu vendi ku mund të vendosni çdo koment në lidhje me çdo pjesë të procesit të kontrollit doping.

Do t'ju kërkohet pëlqimi juaj nëse doni që ekzemplari juaj të përdoret anonimisht për arsye kërkimore pasi analiza e procesit të kontrollit doping të ketë mbaruar. Ju mund të thoni po ose jo.

Jini absolutisht të sigurt që çdo gjë është korrekte, përfshirë numrin e kodit të ekzemplarit.

Sigurohuni, gjithashtu, që në kopjen e formularit të laboratorit të mos të ketë informacione që ju identifikojnë.

Do t'ju kërkohet të firmosni formularin.

Në përfundim të mbledhjes, ju do të merrni një kopje të formularit tuaj të kontrollit doping.

11 PROCESI I LABORATORIT

Ekzemplarët tuaj paktohen për transport me anë të një procesi të sigurt. Ekzemplarët tuaj i dërgohen laboratorëve të akredituar të WADA-s. Kur procedoni ekzemplarët tuaj, laboratorit do të aderojë Standardet Ndërkombëtare të

Laboratorëve, duke siguruar zinxhirin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes.

Analizohet ekzemplari A.

Ekzemplari B sigurohet dhe ruhet. Mund të përdoret për të konfirmuar një Konstatim Analitik Anormal nga ekzemplari A.

Laboratori do të raportojë rezultatet e analizës së ekzemplarit tuaj tek Organizata Anti-Doping përgjegjëse dhe tek WADA.

Po për sa i përket mbledhjes së ekzemplarit të gjakut?

Të njëjtat kushte që zbatohen për ekzemplarët e urinës gjithashtu zbatohen në mbledhjen e ekzemplarëve të gjakut për sa i përket njoftimit, identifikimit, shoqërimit dhe sqarimit të procedurës.

Çfarë ndryshimesh ekzistojnë për minorenët dhe atletët me aftësi të kufizuar?

NJOFTIMI

Nëse jeni minoren apo një atlet me aftësi të kufizuar, kur ju njoftoheni se jeni përzgjedhur për kontroll doping, një palë e tretë mund të njoftohet gjithashtu për këtë përzgjedhje.

DHËNIA E EKZEMPLARIT

Minorenët dhe atletët me aftësi të kufizuar mund të kenë përfaqësuesit e tyre prezent. Megjithatë, ky përfaqësues nuk lejohet të shohë dhënien e ekzemplarit. Pse? Qëllimi është të sigurohet se Oficeri i Kontrollit Doping të shikojë korrektësisht dhënien e ekzemplarit.

Nëse ju vendosni të mos keni një përfaqësues prezent, Agjencia juaj Anti-Doping ose Oficeri i Kontrollit Doping mund të kërkojë një palë të tretë që të jetë prezente.

Nëse ju keni lëvizshmëri të kufizuar apo zhdërvjelltësi doracake të kufizuar, ju mund ti kërkonti përfaqësuesit të atletit ose Oficerit të Kontrollit Doping që t'ju asistojë në mbajtjen e pajisjeve, ndarjen e ekzemplarit apo plotësimin e dokumentave.

Nëse ju keni mungesë të dukshme koordinimit, ju mund të përdorni një enë mbledhëse.

Nëse ju vuani nga një dëmtim viziv, një përfaqësues atleti mund t'ju shoqërojë gjatë gjithë kohës përgjatë procedurës së mbledhjes së ekzemplarit, përfshirë zonën e tualetit. Megjithatë, përfaqësuesi nuk do të shohë kalimin e ekzemplarit. Përfaqësuesi i atletit ose Oficeri i Kontrollit Doping mund të lexojë formularin e kontrollit doping për ju, dhe ju mund ti kërkonti përfaqësuesit të atletëve që të firmosë formularin e kontrollit doping në emër tuaj.

Nëse ju përdorni një kondom drenazhi apo një kateter drenazhi, ju duhet të hiqni qesën mbledhëse ekzistuese dhe të kulloni sistemin në mënyrë që të meret një ekzemplar i ri.

Nëse ju vetë-kateterizoni, ju mund të përdorni kateterin tuaj për të dhënë një ekzemplar. Ky kateter duhet të jetë prodhuar në një mbështjellje të dukshme. Ose përdorni një të dhënë nga Oficeri i Kontrollit Doping, nëse ka në dispozicion.

Një përfaqësues atleti mund të shoqërojë atletin me aftësi intelektuale të kufizuar gjatë të gjithë kohës përgjatë procedurës së mbledhjes së ekzemplarit, përfshirë zonën e tualetit. Megjithatë, përfaqësuesi nuk do të shikojë kalimin e ekzemplarit.



PROCESI I EKZEMPLARIT B

Laboratorët analizojnë ekzemplarë vetëm nëpërmjet numrit të kodit, jo nëpërmjet emrit të atletit.

Një laborator që ka analizuar ekzemplarin A të një atleti raporton rezultatin në të njëjtën kohë tek WADA dhe tek Organizata Anti-Doping.

KONSTATIM ANALITIK ANORMAL

Nëse ekzemplari juaj A rezulton pozitiv – në gjuhën e Kodit, një “Konstatim Analitik Anormal” - organizata përgjegjëse për menaxhimin e rezultateve do të drejtojë një rishqyrtim fillestar.

Ky rishqyrtim fokusohet në dy pjesë:

1. A keni patur një Përrjashtim të Përdorimit Terapeutik për substancën e gjetur në ekzemplar?
2. A është kryer sipas procedurës mbledhja e ekzemplarit dhe analiza?

Ju do të njoftoheni me shkrim për rezultatet dhe të drejtat tuaja në lidhje me analizën e ekzemplarit B.

Nëse ju vendosni të kërkonti një analizë të ekzemplarit B, apo nëse Organizata Anti-Doping kërkon një analizë të ekzemplarit B, ju mund të merrni pjesë apo zgjidhni të dërgoni një përfaqësues në emrin tuaj.

Ndërkohë, një Pezullim i Përkohshëm duhet të imponohet kur ekzemplari A tregon një Konstatim Analitik Anormal apo një Metodë të Ndaluar apo për një Substancë të

Ndaluar përveç një Substancë Specifike. Në të njëjtën kohë, Kodi ju jep të drejtën e seancave dëgjimore të rëndësishme, nëse vendosni ti përdorni ato, në lidhje me imponimin e këtij pezullimi. Këto mundësi variojnë në kohën e çështjes individuale.

Nëse ekzemplari B konfirmon analizën e ekzemplarit A, Organizata Anti-Doping do të procedojë me procesin e menaxhimit të rezultatit, përfshirë të drejtën tuaj për një seancë të paanshme.

Nëse ekzemplari B nuk konfirmon analizën e ekzemplarit A, asnjë veprim i mëtejshëm nuk do të merret dhe, sigurisht, çdo Pezullim i Përkohshëm do të hiqet.

SHENIME



Me mbeshtetjen :

